



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE  
DREJTORIA E KOMPENSIMIT

Nr. 888/prot.  
1

Tiranë, më 22.02.2024

**NJOFTIM**

**PËR SHPËRNDARJE FONDI FINANCIAR PËR KOMPENSIMIN E PRONAVE  
ME KËRKESË TË VEÇANTË**

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) njofton se, më datë **22/02/2024**, ka përfunduar procesin e shqyrtimit administrativ të disa aplikimeve për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, të paraqitura nga subjektet e interesuar, të cilët disponojnë vendime përfundimtare që u kanë njohur të drejtën e kompensimit të pronës.

Procesi i shqyrtimit administrativ të këtyre kërkesave/aplikimeve dhe i shpërndarjes së fondit financiar të kompensimit që ato përfitojnë, bazohet në nenin 17, pika 2, të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” të ndryshuar, në Kreun IV të VKM nr.223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës”.

Aktualisht ka përfunduar shqyrtimi administrativ i **3 (tre) aplikimeve** për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, nga të cilat:

- Për të **3 (tre) aplikimet** ATP ka miratuar me vendim pranimin e këtyre kërkesave/aplikimeve, pasi kanë rezultuar të jenë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 17, pika 2, të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, në Kreun IV të VKM nr. 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar.

Fondi financiar, i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, që ATP do të shpërndajë në total për subjektet përfitues të 3 (tre) aplikimet sipas kërkesave të tyre, është në **vlerën 71,135,867.60 (shtatëdhjetë e një milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë, nga të cilat 14,227,173.52 (katërbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy) lekë do të lëvrohen menjëherë si kështu i parë, ndërsa pjesa tjetër do të lëvrohet me këste çdo fillim viti buxhetor, bazuar në mënyrën e përfitimit të kompensimit për të cilën ka aplikuar subjekti.**

Njëkohësisht bëjmë me dije se, nga përfundimi i trajtimit të këtyre 2 (dy) aplikimeve për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, Buxhetit të Shtetit i kursehet në total një fond në vlerën **136,906,820.40 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet pike dyzet) lekë.**

Të dhënat në lidhje me vendimet e subjekteve të shpronësuar që përfitojnë dhe përfaqësuesit me prokurë të tyre, jepen në listat bashkëlidhur këtij njoftimi.

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) njofton subjektet e interesuara se kështu përkatës për secilin përfitues do të jetë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transfertave bankare në ditët në vazhdim.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Geraldo DURDAJ**



**LISTA E SUBJEKTEVE QË PËRFITOJNË KOMPENSIM FINANCIAR ME KËRKESE TË VEÇANTË**

NR.	VENDIMI I KKKP				QARKU	SUBJEKTI I SHPRONËSUAR		Aplikimi		PËRFAQËSUESI ME PROKURË / APLIKUESI		KËRKESA E SUBJEKTIIT PËR KOMPENSIM TË VEÇANTË
	NR.	DATA	MUAJ	VITI		EMËR	MBIEMËR	Numër dosje	Data e hapjes se dosjes	EMËR	MBIEMËR	
1	1346	30	12	1996	TIRANE	SELMAN	HUTA	124	14.10.2020	ALBION, BUJAR DHE SULEJMAN	HAJDANI, HUTA DHE MEMA	40%
2	440	7	2	1996	TIRANE	NIKOLLA	KOTE	12	24.01.2020	AGIM	KOTTE	40%
3	56	26	3	2008	TIRANE	SELMAN	HUTA	16	21.09.2023	ALBION, BUJAR DHE SULEJMAN	HAJDANI, HUTA DHE MEMA	40%